

## KËRKIME GJUHËSORE

---

Erzen KOPERAJ

### FORMIMI I PASKAJORES DHE ZHVILLIMI I SAJ NË GJUHËN SHQIPE

(Vështrim krahasues mbi qëndrimet për formimin e kësaj forme të pashtjelluar)

Shqipja si gjuhë indoevropiane ka trashëguar mjaft elemente nga trangu i përbashkët, por edhe ka zhvilluar elemente të reja të saj. Këtu bën pjesë edhe sistemi foljor i cili paraqitet i pasur në format e pashtjelluara, disa prej të cilave janë të trashëguara, ndërsa një pjesë janë krijuar si zhvillime të brendshme të shqipes. Në këtë punim do të përqendrohemi tek format e pashtjelluara të shqipes që për nga funksioni janë tërësisht ose pjesërisht të barasvlershme me paskajoren e gjuhëve të tjera indoevropiane, që e kanë këtë formë, tek e ashtuquajtuara paskajore geqe e tipit *me ba* dhe tek forma tjetër e mbarë shqipes, *për të punuar*.

**Paskajorja në gjuhën shqipe.** Folja në formën gramatikore të paskajores shpreh një veprim a një gjendje në mënyrë të përgjithshme, të palidhur me një kohë a vetë të caktuar<sup>1</sup>, midis formave të ndryshme të pashtjelluara, ajo është forma që ka vlerë gramatikore shumë abstrakte, duke shënuar në mënyrë të përgjithshme, të paaktualizuar me tregues gramatikorë, që janë karakteristikë për foljen<sup>2</sup>, ndërsa Jakobson e cilëson si forma që përmban një informacion gramatikor informal. Ndërsa për sa i takon historisë së saj në familjen gjuhësore indoevropiane, sipas B.W. Fortson, paskajorja është një formë e pashtjelluar foljore e cila ka një natyrë të dyfishtë<sup>3</sup>, duke qëndruar mes foljes dhe emrit, duke u lidhur me të parën, jo vetëm nga origjina, po edhe duke qenë se ka kategorinë e diatezës, ndërsa me emrin për sa i takon mjaft funksioneve të rasave që një emër i zakonshëm mund të ketë në funksionet sintaksore, si kryefjalë, kundrinor i drejtë etj. Kështu edhe në shqip mund të shpjegohet që tek forma analitike e gegërishtes *me ba*, apo dhe forma tjetër e pashtjelluar, *për të bërë*, por edhe tek mohorja *pa punuar*, elementi i parë është me origjinë parafjalore. Këto forma paraqesin mjaft probleme dhe kanë qenë në vëmendje të shumë gjuhëtarëve shqiptarë e të huaj, duke qenë një prej pikave më të debatueshme në lidhje me çështjet, nëse ka pasur shqipja një paskajore të mirëfilltë sintetike si gjuhët e tjera indoevropiane. Çështjet, si është krijuar forma analitike e tipit *me ba*, si një zëvendësim i së vjetrës apo një risi brenda shqipes dhe nëse kjo paskajore analitike a ka ekzistuar në toskërisht kanë marrë përgjigj të ndryshme, por pa dhënë një zgjidhje të pakritikueshme?

---

<sup>1</sup> M. Çeliku, "Format e pashtjelluara të foljes në gjuhën e sotme shqipe", Tiranë 2006, f. 31.

<sup>2</sup> S. Mansaku, "Paskajorja e shqipes dhe kategoritë gramatikore të saj", SF. 1. 1982, f. 141.

<sup>3</sup> Sipas B. Fortson, në thelb paskajorja është një emër me origjinë foljore, në gjuhët indoevropiane format e paskajores kanë qenë të larmishme, si abstragim i veprimit duhet të ketë filluar të krijohet në periudhën etnike "Indo-european language and culture", Oxford, 2007, f. 81, 97.

**Prejardhja dhe formimi.** Gjuhësia në këtë pikë i është sjellë një spiraleje, ku janë përvijuar dy qëndrime kryesore, sipas njërës, shqipja nuk e ka njohur paskajoren sintetike si gjuhët e tjera indoeuropiane dhe format e sotme analitike me vlerë infinitivale janë krijime të reja të brendshme të shqipes, ndërsa nga ana tjetër studiues të ndryshëm kanë qenë të mendimit se forma analitike të tipit *me ba*, është derivat i paskajores së hershme që duhet të ketë njohur mbarë shqipja, ashtu si gjuhët si motra. Këtu do t'i referohem vetëm dy autorëve që kanë trajtuar së fundi një çështje të tillë, akademikëve B. Bokshi dhe K. Topalli, të cilët e kanë bërë objekt të monografive të tyre të fundit një çështje të tillë. Sipas studiuesit Besim Bokshi, në dy veprat e tij "*Pjesorja e gjuhës shqipe*" (1998) dhe "*Periodizimi i ndryshimeve morfologjike të shqipes*" (2010), format analitike paskajorja *me* + *pjesore* dhe privativi *pa* + *pjesore* janë përfutur nga dallimi i renditjes së sintagmës adjektivale (*ndezun asht*) prej renditjes së zakonshme të së kryerës (*asht ndezun*), pra si vetë natyra dyfishe e pjesores mes mbiemrit dhe foljes, nga renditja e parë, pjesorja atributive mund të substantivohej duke e nënkuptuar emrin ndaj të cilit ishte përcaktor predikativ. "Ky substantivim kontekstual, ishte i mundur, sepse pjesorja vinte prapa parafjalës, domethënë prapa një segmenti të sigurt të sintagmës prepozicionale, prandaj s'mund të mos ishte në funksion të emrit. Nga substantivimi kontekstual pjesorja kaloi në emër veprimi (*me/pa ndezun* = *me/pa të ndezurit*). Kjo sintagmë kaloi në infinitiv nga funksioni i saj si plotës i mjetit"<sup>4</sup>. Sipas këtij autori, në krijimin e formave analitike me vlerë paskajoreje elementi kryesor ka qenë pjesorja dhe "nuk mund të bëhet fjalë për forma të trashëguara të paskajores të bazuara në ato të pjesores ekzistuese pasive të perfektit"<sup>5</sup>. Sipas këtij argumentimi, shqipja nuk duhet të ketë pasur një formë sintetike të paskajores, dhe forma analitike, *me ba*, që i përgjigjet për nga kuptimi dhe roli paskajores së gjuhëve të tjera është një zhvillim i brendshëm dhe relativisht i vonë në gjuhën shqipe.

Nga ana tjetër, K. Topalli sjell një sërë argumentesh që dëshmojnë se forma foljore me të cila janë ndërtuar format analitike me vlerë paskajoreje, nuk mund të ketë qenë pjesorja e shqipes, e cila ka karakter pësor për të shkuarën, por ajo ka qenë një formë foljore me karakter emëror, siç janë paskajoret e gjuhëve të tjera<sup>6</sup>. Ende sot, sipas këtij studiuesi, tri janë format e pashtjelluara, që duhet të kenë pasur kuptim të tillë emëror;

1) format me prapashtesën *-ë*, si *dekë*, *veshë*, *mbathë*, etj. që reflektojnë rasën kallëzore, ku mbaresa *-on* < *-om*, ka përfunduar në *-ë*;

2) format me tog zanor *shkue*, *çue*, *lye*, *ngjye* etj. që reflektojnë të njëjtën rasë të trashëguar, ku sonantja hundore e prapashtesës *-on* ka shkaktuar hapjen në diftong të zanoreve të temës;

<sup>4</sup> B. Bokshi "Periodizimi i ndryshimeve morfologjike të shqipes", Prishtinë 2010, f. 61 si dhe tek "Pjesorja e shqipes, vështrim diakronik" Prishtinë 1998, f. 140-141.

<sup>5</sup> B. Bokshi, "Pjesorja e shqipes, vështrim diakronik", Prishtinë 1998, f. 14.

<sup>6</sup> K. Topalli, *Sistemi foljor i gjuhës shqipe*, Tiranë 2010, f. 478.

3) format pa mbaresë, si : *la, qa, ba* etj., që përmbajnë vetëm temën e foljes<sup>7</sup>.

Kështu që pjesorja, e cila më pranë qëndron me mbiemrin, nuk mund të merret parafjalë përpara saj, madje edhe forma më e re e pashtjelluar e tipit *për të punuar*, ka marrë parafjalën *për*, kur pjesorja ka shërbyer si element i emrit prej pjesor *të punuar*, madje edhe tek forma *për me punue, me* nuk është një parafjalë, po një element i desemantizuar dhe i gramatikalizuar, duke u shndërruar në një tregues të formës së pashtjelluar paskajore<sup>8</sup>.

Në të mirë të këtij qëndrimi do të shtoja: Duke analizuar distribucionin e funksioneve sintaksore të paskajores së tipit *me ba* mund të themi se ajo shërben në role karakteristike për një folje dhe një emër, do të ndalemi tek funksionet e ngjashme me këtë të fundit:

Funksioni i **kryefjalës**: *asht turp e marre me u krye kso dore pasunija e nji komit të vorfën; se me vra mas krahit, s' asht adet ndër ne..*

Funksioni më tipik është ai i **kundrinorit**. Ajo përdoret rregullisht në pozicionin e kundrinorit, sidomos pas foljeve që shprehin modalitetet e mundësisë, domosdoshmërisë, apo dhe të vullnetit të kryefjalës.

*Kishte msue me dashtë edhe anmikun* (Fishta HD, 1923 f. 194) *Mendonte me u forcue ma tepër.*

*Ti Halil me u martue s'po don.* (Visaret e kombit, V. II f. 28)

Funksioni si **përcaktor**: *Ke falë ditën me punue/ ke falë natën me pushue.* (Visaret e kombit, V. II f. 31).

Duke u nisur nga shpërndarja e këtyre funksioneve sintaksore mund të dalim në përfundimin se paskajorja e shqipes realizon ato ngjashmërisht si në gjuhët e tjera indoeuropiane, role që luan një emër në rasën emërore dhe kallëzore, aq sa është folur edhe për të ashtuquajturat rasa emërore dhe kallëzore të paskajores<sup>9</sup>. Prandaj daljes së formave analitike me element të parë parafjalët *me, për*, dhe *pa* karakteristike për rasën kallëzore, duhet të ketë qenë e natyrshme dhe logjike edhe për shqipen t'i paraprinte një formë emërore, të cilën mund ta luante vetëm paskajorja.

Kalimi këtyre parafjalëve si formant dallues i paskajores nga pjesorja duhet të ketë filluar në një periudhë kur vetë prapashtesat e pjesores dhe paskajores sintetike kanë rënë, sidomos tek foljet me temë në zanore, ku siç e cilëson Bokshi kanë dalë me sufiksin zero<sup>10</sup>. Prandaj në një periudhë të tillë të riorganizimit të formave të pashtjelluara, parafjala e dikurshme është desemantizuar dhe ka kaluar në të vetmin element formëdallues.

Përsa i takon shtrirjes së kësaj forme, nëse ka qenë pjesë e mbarë shqipes, apo vetëm e gegërishtes, çka lidhet edhe me diskutimin në kuadrin e gjuhësisë

<sup>7</sup> Po aty.

<sup>8</sup> S. Riza, *Çështja e paskajores në shqipe*, Vepra IV, Prishtinë 2004, f. 53.

<sup>9</sup> M. Çeliku, *Format e pashtjelluara të foljes në gjuhën e sotme shqipe*, Tiranë 2006, f. 32.

<sup>10</sup> B. Bokshi "Periodizimi i ndryshimeve morfologjike të shqipes", Prishtinë 2010, f. 159-160.

ballkanike, duhet përqendruar vëmendja në dy pika, së pari tek raporti me format e lidhore që janë gegjëset e paskajores *me ba*, në toskërishte, dhe së dyti, a ka elemente të kësaj paskajoreje në toskërishte? Duke qenë se dhe në fillim iu referova përkatësisht studiuesve B. Bokshi dhe K. Topalli, po i kthehem argumenteve të tyre: i pari bashkohet me mendimin e shumë studiuesve të tjerë që forma e tipit *me ba*, duhet të ketë qenë e mbarë shqipes, e më pas është zhdukur në dialektin e jugut si në shumë gjuhë të tjera të Ballkanit, rreth shekullit XI, ndërsa sipas Prof. Topallit, kjo formë e pashtjelluar nuk duhet të jetë formuar në toskërisht, ku pjesorja duhet të ketë kristalizuar prapashitesat e saj para se tipi *me ba* të formohej në gegërisht. Sipas tij forma *me ba* është më e vonë se forma mohore *pa bërë*, apo dhe vetë përcjellorja *duke bërë*, që i përkasin mbarë shqipes, pavarësisht se ato janë formuar në të njëjtën mënyrë, *parafjalë + paskajore* e dikurshme. Në këtë pikë, mendoj se arsyeja se pse mohorja *pa bërë* dhe përcjellorja *duke bërë*, janë pjesë e mbarë shqipes, është se këto dy forma nuk mund të zëvendësoheshin nga format e lidhore. Ashtu si dhe në mjaft gjuhë të tjera ballkanike duhet të ketë ekzistuar një situatë psikolinguistike ku format e lidhore kanë qenë më shprehëse sesa ato të paskajores. Një presion të tillë të lidhore ne mund ta konstatojmë edhe tek autorët tanë të vjetër, pikërisht tek Buzuku dhe Budi, në dallim me Bardhin e Bogdanin, ku të parët dallohen për stilin e tyre tejet popullor dhe shumë pranë gjuhës së folur. Duke analizuar funksionet sintaksore të formave të pashtjelluara me vlerë paskajoreje në krahasim me ato të lidhore tek autorët tanë të vjetër të shqipes së shkruar, Buzuku dhe Budi, shihet qartë se këto forma përdoren me të njëjtat funksione dhe distribucion të përafërt, madje jo rrallë edhe me një mbizotërim të formave të lidhore, sidomos në ndërtimet e pavarura. Ky presion i lidhore mund të kuptohet për faktin që lidhorja është shumë më pranë ligjërimit popullor, mesazhit të drejtpërdrejtë, në raport me paskajoren ajo është formë vetore, më e përshtatshme për të funksionuar si një kallëzues në fjalitë e pavarura, por edhe duke zgjeruar funksionet e saj sintaksore gati në sinonimi me paskajoren. Duke analizuar gjuhën e Buzukut dhe të Budit, përdorimi i lidhore në rolet tipike të paskajores është një fakt shumë i shpeshtë:

*Sikur një pasqyrë, ndë të cijt tu shukuom, të nçilenë ma mirë e të jenë ndihmuom kishësë për shërbëtyrë...si e kanë për detyrë, të vinjënë penduom....*<sup>11</sup>

Duke vështruar ndërtimet me foljet *mund* dhe *duhet* tek Meshari i Buzukut, prof. S. Mansaku nxjerr një statistikë, ku në raportin e distribucionit të paskajores dhe lidhore, më shumë kemi përdorimin e lidhore në sintagmat me *mund* dhe të paskajores me foljen *duhet*. Ky rezultat me të drejtë të shpie në mendimin se lidhorja e zëvendësonte paskajoren edhe në ndërtimet më karakteristike të kësaj forme të pashtjelluar: "...mund të supozohet që procesi i zëvendësimit të paskajores nga lidhorja kishte filluar prej kohësh, dhe në kohën e Buzukut kishte përparuar aq shumë sa të prekte dhe ndërtimet më tipike me foljet modale *mund* dhe *duhet*, ose mund të mendohet që vetë forma e paskajores së tipit

<sup>11</sup>P. Budi, "Dottrina christiana", Romë, 1616, f. 408.

## FORMIMI I PASKAJORES DHE ZHVILLIMI I SAJ NË GJUHËN SHQIPE

*me punue* është një krijim relativisht i ri i një kohe kur lidhorja kishte zënë vend në të gjitha ndërtimet e mundshme<sup>12</sup>. Por mbijetesa e kësaj forme në gegërisht duhet të ketë ardhur nga zgjerimi i funksioneve sintaksore, si dhe ndjenja infinitivale të ndërgjegjja gjuhësore e shqipfolësit, çka vihet re edhe në dialektin e jugut në krijimin e formës analitike *për të punuar*. Paskajorja e tipit *me ba*, paraqitet më fleksibël se forma tjetër e pashtjelluar e tipit *për të ardhur*, madje dhe se paskajoret në gjuhë të ndryshme i. e. Përsa i takon formës analitike të tipit *për të bërë*, ajo ka pjesërisht vlerën e një paskajoreje. Ajo përdoret në shumicën e funksioneve themelore infinitivale, por me funksione sintaksore të kufizuara<sup>13</sup>. Rregulli që nënvizon Kayne në “The antisymmetry of syntax” (1994), se frazat që mbartin komplementues të tipit *that* (ang.), apo *que* (frëngj.) selekcionojnë vetëm fjali me forma foljore të shtjella<sup>14</sup>, nuk qëndron për paskajoren *me ba*, p.sh. *mendoj që me u nis herët* (krahas. *Mendoj që për t’u nisur herët*) duke qenë në simetri sintaksore me lidhoren (krahas. *Mendoj që të nises herët*). Nga ana tjetër, gjurmë të paskajores gjejmë edhe në toskërishte. Këtë mendim të diskutueshëm herë pas here e përforcojnë edhe kërkimet dialektologjike të Universitetit të Kozencës, në Kalabri. Në tekstet e vjetra arbëreshe të viteve 1700, si tek *Kodi i Kjeutit* i Nikollë Filjes, ku rastet e përdorimit të tipit *për me bërë* janë të shpeshta sa nuk mund të mendohet thjesht si një ndikim i autorëve gegë tek ata arbëresh<sup>15</sup>. Sipas Fr. Altimarit, këtë e përforcojnë edhe kërkimet dialektologjike të kryera në të folmet arbëreshe të Kalabrisë veriore, ku edhe në ditët tona e ruajnë në përdorim në funksion qëllimor, *për me ngrënë*, *pri me ngrënë* apo *pri ma pir*, në Fermë, Shën Vasil, por edhe në Shën Mërtiri e Çivëti<sup>16</sup>, duke dëshmuar se kjo formë e pashtjelluar duhet të ketë qenë e mbarë shqipes, meqë mund të gjenden gjurmë të saj edhe pse gramatikalisht të ngurosur në gjuhën e folur të arbëreshëve të Italisë, dhe jo vetëm në veprat letrare të shkrimtarëve arbëresh. Këtyre shembujve të sjellë nga prof. Fr. Altimari do t’i shtonim edhe formën e paskajores që del tek kënga e shën Lazarit që këndohet në Piana dei Greci dhe në Contessa Entellina, *O Lazar*,

<sup>12</sup> S. Mansaku, “Ndërtimet me foljet modale mund dhe duhet te Gjon Buzuku”, SF. 3, 1979, f. 155; autori bashkohet me mendimin e E. Çabejt, se paskajorja e gegërishtes ishte një inovacion që nuk arriti të shtrihet në mbarë shqipen.

<sup>13</sup> Akademia e Shkencave e Shqipërisë, “Gramatika e gjuhës shqipe”, Vëll. I, Tiranë, 2002, f. 339.

<sup>14</sup> M. Manzini, L. Savoia, “A unification of morphology and syntax. Investigation into romance and albanian dialects”, Routledge New York, 2007, dhe F. Koleci, “Ndërtime të varura sintaksore të shqipes: çështja e paskajores dhe e ndërtimeve të tjera foljore të pashtjelluara”, në Identitete gjuhësore dhe kulturore, Shkodër 2010, f. 152.

<sup>15</sup> Sipas Fr. Altimarit, “...denduria e kësaj forme paskajoreje dhe përdorimi i saj plotësisht i integruar brenda sistemit foljor të së folmes së Munxifit, na shtyjnë ta konsiderojmë atë me siguri me prejardhje nga gjuha e folur arbëreshe dhe jo si një formë e huazuar nga tekstet e shkruara të ndonjë shkrimtari me origjinë gege të kohës” në Identitete gjuhësore dhe kulturore, Shkodër 2010, f. 39.

<sup>16</sup> F. Altimari, “Selman Riza dhe çështja e paskajores” në Identitete gjuhësore dhe kulturore, Shkodër 2010, f. 41.

*Lazar, ngreu e rrëfiej që vjen me thënë kjo mortje e shkretë.*<sup>17</sup> E njëjta dukuri ndeshet edhe në greqishten e re e në bullgarishte, ku humbja e paskajores është edhe më e madhe në krahasim me shqipen dhe ku forma të tilla të paskajores vazhdojnë të mbijetojnë në trajta të ngurosurat të shprehjeve popullore, shpeshherë si kalke të modeleve të tjera gjuhësore, frazeologjike apo sintagmash të ndryshme. Duke iu referuar edhe historisë të shekujve IX-XII, kur popujt e Ballkanit jetonin në kushte të ngjashme shoqërore, kulturore dhe fetare, përhapja e kësaj ballkanizme duhet të ketë qenë mëse e mundshme.

### **Përfundim**

Paskajorja në gjuhën shqipe duhet të ketë ekzistuar në formën e saj sintetike, ashtu si në mjaft gjuhë simotra indoevropiane. Duke qenë më pranë kategorisë së emrit, paskajorja ka krijuar formën e saj analitike më vonë, duke përdorur elemente me burim nga parafjalët e rasës kallëzore. Krijimi i formës analitike ndoshta ka ardhur edhe si rezultat i dallimit nga forma e pjesores, në një kohë kur duhet të jetë bërë riorganizimi i eptimit qoftë tek emri ashtu dhe tek folja, periudhë kur duhet të jetë bërë edhe riorganizimi i prapashitesave të pjesores, pasi zhvillimet e një gjuhe bëhen në sistem. Duke e vështruar në kuadrin e gjuhësisë ballkanike, zhdukja e paskajores duhet të ketë filluar në shekujt e parë të mijëvjeçarit të dytë, çka ka ndodhur edhe në një pjesë të shqipes, përkatësisht në dialektin jugor të saj, së pari për shkak të shtrirjes së funksioneve të lidhore dhe rritja e shprehjes së formave të saj si më popullore dhe të drejtpërdrejta. Është periudha që për Ballkanin jugor dhe Italinë e Jugut ky ndikim gjuhësor ka qenë i dukshëm dhe i një karakteri popullor, çka mund ta gjykojmë si një ballkanizëm të mirëfilltë. Ekzistencën e kësaj forme të pashtjelluar në mbarë shqipen e dëshmojnë edhe disa mbeturina të përdorimit të saj tek arbëreshët e Italisë, në të folmet e të cilëve paskajorja nuk duhet të jetë zhdukur më shumë se dy-tre shekuj para shpërnguljes së tyre nga trojet amtare. Tkurrja e gjeografike që pësoi më pas kjo formë bëri që të kthehet në një prej dallimeve dialektore brenda shqipes.

### **BIBLIOGRAFI**

- Ajeti, I. *Historia e Gjuhës Shqipe*, Prishtinë, 1969.
- Altinari, Fr. *Selman Riza dhe çështja e paskajores*, Identitete gjuhësore dhe kulturore, Shkodër 2010.
- Akademia e Shkencave e Shqipërisë, *Gramatika e gjuhës shqipe*, Vëll. I, Tiranë, 2002.
- Bokshi, B. Pjesorja e shqipes, vështrim diakronik, Prishtinë. 1998.
- Bokshi, B. Periodizimi i ndryshimeve morfologjike të shqipes, Prishtinë. 2010.
- Çeliku, M. Format e pashtjelluara të foljes në gjuhën e sotme shqipe, Tiranë. 2006.
- Demiraj, Sh. Rreth disa problemeve të paskajores në gjuhën shqipe, SF 1, 1969, 81-120.
- Demiraj, Sh. Rreth zhdukjes së paskajores në gjuhën shqipe, SF 1, 1971, 71-77.
- Demiraj, Sh. Gramatikë historike e gjuhës shqipe, Tiranë, 1986.

<sup>17</sup> K. Kamsi, "Shqiptarët e Italisë", Shkodër 2006, f. 104

#### FORMIMI I PASKAJORES DHE ZHVILLIMI I SAJ NË GJUHËN SHQIPE

---

- Demiraj, Sh. *Gjuhësi ballkanike*, Shkup, 1994.
- Fortson, B.W. *Indo-european language and culture*, Oxford, 2007.
- Mansaku, S. Ndërtimet me foljet modale mund dhe duhet te Gjon Buzuku, SF. 3, 1979, 135-157.
- Mansaku, S. Paskajorja e shqipes dhe kategoritë gramatikore të saj, SF. 1, 1982, f. 139-161.
- Mansaku, S. Funksionet sintaksore të paskajores tek autorët e vjetër, SF. 2, 1983, f. 99-113.
- Topalli, K. *Sistemi foljor i gjuhës shqipe*, Tiranë 2010.
- Topalli, K. *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, Tiranë 2011.
- Riza, S. *Tri monografia albanologjike*, Vep. I, Prishtinë, 1996.